

DICASH

PRODUKT PER MBROJTJEN E BIMEVE



GHS09 "KUJDES"

"Lexo fletudhëzuesin para përdorimit"

DICASH është një herbicid i pas mbirjes së misrit për kontrollin e barerave të keqja gjethëgjera dhe shumë vjecare. Zëton efekt mbetës dhe sistematik duke u thithur si nga sistemi rrenjor ashtu edhe ai gjethor. Në këtë mënyrë, pas kontaktit me bimën, qarkullon me shpejtesi në lëngjet bimore në të gjitha drejtimet duke u akumuluar në zonat me aktivitet të lartë fiziologjik dhe duke ndërprerë proceset e rritjes së metejeshme të bimeve.

Lënda vepruese: 480 gr/lit Dicamba.

Formulimi: Lëng i tretështes (SL).

Masat parambrojtëse:

- P102: Mbajeni larg aritjes prej femijeve.
- Ruajeni në vende të thata dhe të fresketa, larg ushqimeve dhe pijeve për njerëzit si dhe ushqimeve për blegtorinë.
- Evitoni kontaktet zgjatura të syve dhe lekures me preparatin.
- Evitoni marrjen e preparatit me organet e frymëmarrjes gjatë përgatitjes së solucionit spërkates dhe gjatë spërkatjes.
- Gjatë përdorimit të tij mos ha e mos pi ujë dhe duhan.
- EUH401: Për të shmangur reziqet ndaj shëndetit të njerëzve dhe ndotjes së mjedisit vepron në përputhje me instruksionin e përdorimit.
- Gjatë punës përdor paisje mbrojtëse, kominoshe, doreza, maska, syze.
- Sp02: Pas punës lani robotat dhe veshjet mbrojtëse.
- P501: Bej asgjësimin e enëve dhe mbetjeve të produktit në përputhje me rregullat në fuqi.

Udhëzime për ndihmën e parë dhe këshilla për mjekun:

- H302: Në demshëm nëse gëlltitet. Në rast gëlltitjeje, marrje me organet e frymëmarrjes dhe me lekuren shkakton keto shenja: iritim të syve, spazme muskulare, dispnea, cionozë, ataksi të mundeshëm, bradikardi.
- H319: Shkakton iritime serioze në sy.
- Në rast helmimi pacienti dërgohet në një qendër spitalore ku përdoret terapi simptomatike.

Përdorimi:

Kultura	Doza	Koha e aplikimit	Karenca PHI
Në bimë foragjere dhe Misër	0.6-0.75 l/ha, në 200-400 lit ujë	Nga faza 2-5 gjethë të vërteta	Nuk aplikohet
Grurë dimëror	0.2 l/ha, në 200-300 lit ujë	Nga faza 2-6 gjethë të vërteta	Nuk aplikohet
Elbi dimëror dhe pranveror	0.2 l/ha, në 200-300 lit ujë	Nga faza 2-6 gjethë të vërteta	Nuk aplikohet
Livadhe dhe kullota	0.5-0.6 l/ha, në 300-500 lit ujë	Nga faza 2-6 gjethë të vërteta për të barëra gjethëgjera njëvjeçare dhe në fazën e rritjes intensive të barërave gjethëgjera shumëvjeçare	14 ditë

Barërat e këqija që kontrollojnë:

Emri i barit të keq	Emri Latin
Barërat e këqija gjethëgjera	
Nena	<i>Amaranthus retroflexus</i>
Trasta e çobanit	<i>Capsella bursa-pastoris</i>
Laboti i egër	<i>Chenopodium polyspermum</i>
Tatulla	<i>Datura stramonium</i>
Laboti	<i>Chenopodium album</i> , <i>Chenopodium hybridum</i> , <i>Atriplex patula</i>
Bamja e egër (Bamja e qeve)	<i>Hibiscus trionum</i>

Hithëbuta e pupurtë	<i>Lamium purpureum</i>
Nejca pjeshkore	<i>Persicaria maculosa</i>
Nejca	<i>Fallopia convolvulus</i>
Veronika	<i>Veronica sp.</i>
Pelini Amerikan	<i>Ambrosia artemisiifolia</i>
Pereniku, Gjembë i bardhë	<i>Cirsium arvense</i>
Dredhja e arave	<i>Convolvulus arvensis</i>
Galisoga lulevogël	<i>Galinsoga parviflora</i>
Glekoma urthore	<i>Glechoma hederacea</i>
Barsapuni i arave	<i>Anagallis arvensis</i>

Vërejtje per perdorimin:

Nuk duhet hyre ne parcelen e trajtuar me pare se 24 ore. Mos e perdorni produktin ne mot me ere. Mos riperdor enet mbajtese te ketij produkti per qellime te tjera dhe mos i shpernda ato ne menyre te cregullt ne mjedis.

Menaxhimi i rezistencës:

Për të zvogëluar rrezikun e zhvillimit të rezistencës, rekomandohen trajtime të alternuara me herbicide që u përkasin grupeve të ndryshme kimike dhe që kanë një mënyrë tjetër veprimi.

Fitotoksiciteti:

Mund të jetë fitotoksik në tokat gelqerore. Mund të demtojë kulturat e aferta vecanerisht pambukun, sojen, domaten, kungullin, sallaten.

Ndikimi në ekosistem:

H412: Helmues dhe me efekt të zgjatur ndaj organizmave ujore. SP1: Mos ndotni ujërat me produktin ose enet mbajtese të tij. Mos pastroni paisjet e përdorimit afër sipërfaqeve ujore. Shmangni ndotjen e neprmet kanaleve ujore të fermave ose rrugëve. Sp3: Për të mbrojtur bimesinë e ndodhur jashtë zonës së perkatese, një zonë periferike prej 5 m duhet lene pa sperkat. P273: Shmangni hedhjet në mjedis. P391: Grumbullo rrjedhjet. Helmues për bletët por këto burime të ekspozimit konsiderohen shumë të pamundura në rastin e aplikimit të DICASH, pasi mundësitë që bletët të jenë në fushat pas mbirjes së mistrit është jashtëzakonisht e ulët. Fushat e hershme pas dhe para mbirjes së misrit nuk janë tërheqëse për bletët, pasi ato nuk ofrojnë ndonjë burim ushqimi.

Karenca:

Nuk aplikohet. Kujdes: Në rast perzierje me produkte të tjera, duhet të respektohet produkti me karence me të gjate.

Ruajtja dhe magazinimi:

Produkti ruhet në vende të fresketa dhe të thata, larg rezerve direkte të diellit.

Nr dhe data e regjistrimit: 745, datë 4.12.2020;

Sasia neto e PMB-se, që ndodhet në ambalazhin baze: 500 ml, 1 lit;

Data e prodhimit: _____;

Datën e skadencës së PMB-së, ruajtur sipas kërkesave të përcaktuara në dosje: 3 vjet;

Numri i partise së mallit (serise) ose shenja të tjera identifikuese: _____;

Tipi i ambalazhit baze: Shishe HDPE ose COEX;

Emri dhe adresat prodhuesit: Sharda Cropchem Ltd. **Adresa:** Mumbai-Indi.

Emri dhe adresa e aplikantit: Sharda Cropchem Espana SL. **Adresa:** Murcia, Spanjë.